

Vendim nr. 27, datë 23.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 23.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (I) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIR MUZHAQI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-88, datë 21.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në gjykimin e zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka rezultuar se kërkuesi është arrestuar në datën 09.10.2014 dhe është dënuar për kryerjen e katër veprave penale. Konkretisht, me vendimin nr. 231, datë 30.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili ka marrë formë të prerë në datën 11.09.2014, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 3 vjet e 6 muaj burgim, ndërsa me vendimin nr. 755, datë 10.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 11.04.2015, ai është

dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim. Po kështu, me vendimin nr. 408, datë 24.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.05.2015, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim dhe me vendimin nr. 90, datë 27.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 24.05.2017, ai është dënuar përfundimisht me 3 vjet burgim. Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit kërkuesi ka vuajtur gjithsej 6 vjet e 5 muaj e 5 ditë, deri në datën 29.01.2021. Për këto arsye, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur në gjykatë kërkesën nr. 613/142 akti, duke kërkuar bashkimin e dënimeve të dhëna ndaj kërkuesit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 613/142, datë 19.02.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe bashkimin e dënimeve të dhëna me vendimin nr.755, datë 10.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 10.04.2015 me vendimin nr. 408, datë 24.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.05.2015, në ngarkim të kërkuesit, në një dënim të vetëm prej 6 vjetësh burgim. Sipas asaj gjykate, vuajtja e dënimit duhet të fillojë të llogaritet nga data 22.09.2020. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-1434 (250), datë 29.07.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 613/142 (13-2021-1353), datë 19.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në këtë mënyrë: “Bashkimin e dënimeve të dhëna me vendimin nr. 755, datë 10.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 10.04.2015 me vendimin nr. 408, datë 24.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili ka marrë formë të prerë në datën 29.05.2015 me vendimin nr. 90, datë 27.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 24.05.2017, në ngarkim të kërkuesit, në një dënim të vetëm prej 6 vjetësh burgim.”. Sipas gjykatës së apelit, vuajtja e dënimit duhet të fillojë të llogaritet nga data 22.09.2017. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-88, datë 21.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. Në datën 28.10.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 06.11.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, duke argumentuar se i është cenuar:

6.1. *E drejta e aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, sipas nenit 434, pika 1, të KPP-së, si dhe nuk i ka kërkuar atij memorie me shkrim sipas parashikimit të nenit 432, pika 2, të po këtij kodi.

6.2. *Parimi i paanshmërisë*, pasi në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari I.P., i cili ka qenë në kushte papajtueshmërie, pasi ka shqyrtuar disa kërkesa të tjera të paraqitura nga kërkuesi dhe as nuk rezulton që të ketë hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se ka shfaqur mendime me vlerësimet e tij për proceset e mëparshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që

mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se është cenuar *e drejta e aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, si dhe *parimi i paanshmërisë*, për shkak se gjyqtari I.P., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar rekursin e kërkuesit në Gjykatën e Lartë ka shqyrtuar më parë edhe çështje të tjera të tij.

10. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i paraqitur nga kërkuesi, ku janë parashtruar dhe shkaqet e tij. Sipas nenit 432 të KPP-së, rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet: a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e

Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po sipas nenit 432 të KPP-kur e çmon të nevojshme, gjykata u kërkon palëve memorie me shkrim.

12. Në kuptim të sa më sipër, së pari, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim kanë natyrë thelbësisht ligjore, pasi kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të ligjit procedural nga Gjykata e Lartë. Së dyti, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë, në funksion të së drejtës së aksesit në atë gjykatë, i ka verifikuar pretendimet e ngritura në rekurs dhe në përfundim ka vlerësuar se ato janë të pabazuara në kuptim të nenit 432 të KPP-së. Vendimi i Kolegjit Penal nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu edhe kërkesat për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj si gjykatë e ligjit, ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, pa i kërkuar memorie me shkrim kërkuarit sipas pikës 2 të nenit 432 të KPP-së, kërkesë e cila është në diskrecionin e saj (Gjykatës së Lartë) për ta kërkuar kur e çmon të nevojshme, në varësi të rastit në shqyrtim, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim vendimmarrjen e saj. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

13. Po kështu, kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për shkak se në përbërje të trupit gjykues në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtari I.P., i cili ka shqyrtuar më parë kërkesa të tjera të paraqitura nga ai. Në rastin konkret, Kolegji vëren se edhe pse kërkuari ka barrën e provës në këtë drejtim, ai nuk ka paraqitur as argumente, as ndonjë akt provues, ose të dhënë për të mbështetur pretendimin e tij, si më sipër. Kërkuari nuk ka arritur të provojë se proceset gjyqësore në të cilat pretendohet prej tij se ka marrë pjesë më parë gjyqtari i Gjykatës së Lartë kanë të bëjnë me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore, çka mund të ketë krijuar një dyshim të justifikuar se vendimi i dhënë prej tij në rastin konkret ka qenë produkt i një procesi të njëanshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

14. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji evidenton se nuk është e nevojshme analiza e mëtejshme të plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuarit.

15. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.